

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 1/3</b>

*PSB, 24.11.2021*

**Titulli i DPS/KT:**

**DPS/KT 230 “Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës”**

## **A Historiku**

DPS/KT 230 është krijuar në 14.02.2002, në përputhje me Ligjin Nr. 9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare në lidhje me kërkesat e standardizimit në fushën e cilësisë së ujit, përcaktimin e kushteve së marrjes së mostrave të ujërave ,matjen dhe raportimin e karakteristikave të ujit. Për sa i përket matjes së karakteristikave të ujit këtu përfshihen matjet fizike, kimike biokimike, biologjike dhe matjet mikrobiologjike. Brenda fushëveprimit të këtij KT një rëndësi e veçantë i jepet aspektit mjedisor i cili ka të bëjë me kontrollin e sipërfaqes së ujit (lumenj, përrenj, liqene, rezervuare, dete (ujëra detar), ujëra në terren dhe precipitimi i tyre. Nga ana tjetër një rol të madh luan dhe kontrolli i cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor,si dhe për qëllime të tjera si përshtatshmëria për përpunim industrial.

## **B Mjedisi i biznesit**

### **B.1 Të përgjithshme**


Puna e KT 230 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të ngritjes së metodave të monitorimit të cilësisë së ujit, kjo nënkupton që ky komitet teknik nuk është i përfshirë në standardizimin e produktit por në standardizimin e procedurës. Metodave analitike të cilat përfshihen në këtë KT shpesh shërbejnë si bazë për legjisllacionin kombëtar për kontrollet e cilësisë së ujit. Çdo organizatë qeveritare ose mjedisore ka përfitime nga metodat analitike të cilat kryhen pranë këtij KT siç mund të jetë një nga këto përdorimi i metodave të vlefshme analitike për ti shërbyer qëllimeve të monitorimit. Udhëzimet e përcaktuara në KT 230 në teknikat e marrjes së mostrës, në kontrollin analitik të cilësisë së ujit ndihmon në ngritjen e një baze për praktikatat e mira laboratorike për monitorimin e ujit. Terminologjia e KT 230 është mjaft e qartë dhe e kuptueshme në lidhje me kushtet teknike e analizave të ujit.

### **B.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit**

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga KT 230 përfshijnë konsumatorët, organizmat e certifikimit dhe laboratorët e testimit, shitësit dhe autoritetet kombëtare të inspektimit.

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë:

- përmirësimin e cilësisë së produktit;
- kontrollin e prodhimit;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;
- ndihmën në globalizimin e ekonomisë të bazuar në konkurrencë.

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 2/3</b>

## C Përfitimet

Puna e KT 230 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- zhvillimin e industrisë së përdorimit të ujit; për përpunimin kimik si dhe për pajisjet e industrisë prodhuese,
- lehtësimin e lidhjes midis prodhuesve, konsumatorëve dhe organeve përgjegjëse për inspektimin dhe testimin teknik;
- mbështetjen për legjislacionin evropian.

## D Pjesëmarrja në DPS/KT 230

Në KT 230 ka përfaqësues nga institucione publike, ekspertë të fushës së mjedisit, ujit, Qendra e Monitorimit të Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si dhe nga Instituti i Shëndetit Publik i cili merret direkt me kontrollin e tregut, monitorimin e cilësisë së ujit (ujërat sipërfaqësore, ujët e pijshëm, mbetjet, ujërat për larje), monitorimin e efekteve të shkarkimeve industriale në shëndet dhe ndërhyrja në rastin e ndotjes aksidentale të ujit, si dhe zhvillimin dhe aplikimin e planeve të kontrollit të cilësisë së burimeve të ujit të pijshëm dhe evakuimit të ujit të ndotur. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

## E Objektivat dhe strategjitë

### E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/KT 230

- Miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, për sigurinë e përpunimit të metodave të marrjes së mostrave të ujit, analizave kimike, biologjike, mikrobiologjike dhe fizike, që mbulohen nga ky KT, duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;
- Gjurmimi i standardeve të reja në këtë fushë.

### E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përbushja e objektivave të KT 230 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 137	Vlerësimi i ekspozimit ndaj vendit të punës që kryhen punë kimike dhe agjentët biologjikë
CEN/TC 164	Furnizimi me ujë
CEN/TC 165	Inxhinieria e mbeturinave të ujit
CEN/TC 183	Menaxhimi i mbeturinave
CEN/TC 195	Filtrat e ajrit për pastrimin e ajrit të përgjithshëm
CEN/TC 230	Analizat e ujit
CEN/TC 243	Teknologjia e dhomave të pastra (etalonë në ndihmë të klasifikimit të pastërtisë së ajrit)
CEN/TC 264	Cilësia e ajrit



Emri i institucionit:

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT**

Dokumenti Nr.:

RC/DS/117

Titulli:

**Plani strategjik i biznesit për DPS/KT**

Versioni:

01

Faqe Nr.:

Faqe 3/3

CEN/TC 292	Karakterizimi i mbeturinave
CEN/TC 308	Karakterizimi i llumrave
CEN/TC 345	Karakterizimi i tokës (dherave)
CEN/SS S26	Menaxhimi i mjedisit
CEN/SS S27	Mbeturinat - Karakterizimi, Trajtimi dhe Lumenjtë
ISO/TC 146	Cilësia e ajrit
ISO/TC 147	Cilësia e ujit
ISO/TC 190	Cilësia e tokës
ISO/TC 224	Aktivitetet e shërbimeve në lidhje me sistemet e ujit të pijshëm dhe sistemet e ujërave të zeza - Kriteret e cilësisë së shërbimit dhe performance e indikatorëve
CEN/TC 402	Pishina të brendshme dhe SPA
CEN/TC 430	Energjia bërthamore, teknologjitë bërthamore dhe mbrojtja radiologjike
CEN/TC 444	Karakterizimi mjedisor i matricave të ngurta
CEN/TC 426	Pajisjet shtëpiake të cilat përdoren për trajtimin e ujit

**F Planifikimi**

Për realizimin e objektivave të më sipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

**G Financimi**

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

**Sekretari i DPS/KT 230****(Elona TELULI)**